



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

Prishtinë/Prishtina, rr./ul. Agim Ramadani tel. +381 (0) 38 551 679; kqz.sekretarati@kqz-ks



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 dhe neneve 87.1, 87.2, 87.5, 87.6, 87.7 si dhe 87.8 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 30.07.2009 nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Fletëvotimit për Zgjedhjet Lokale, Zgjedhjet për Kryetar të Komunave dhe Raundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetar të Komunave

- I. Miratohet rekomandimi i Këshillit të Operacioneve Zgjedhore të KQZ-së i datës 23.07.2009 për dizajnin/formatin dhe përmbajtjen e Fletëvotimit (FLV) për Zgjedhjet Lokale dhe Zgjedhjet për Kryetar të Komunave të datës 15 nëntor 2009, dhe Raundin e dytë të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave.
- II. Formati i Fletëvotimit për Zgjedhjet Komunale dhe për Kryetar të Komunave do të jetë A/3 ndërsa për Zgjedhjet e Raundit të dytë për Kryetar të Komunave A/5
- III. Kopjet e FLV-ve për zgjedhjet si në pikën I i janë bashkangjitur këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij .
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me datë 30 korrik 2009.

Prishtinë, 30 korrik 2009

Nesrin Lushta

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve